

L I G J
Nr.8033, datë 16.11.1995

**PËR TRANSFORMIMIN E BANKAVE TREGTARE SHTETËRORE NË SHOQËRI
TREGTARE DHE LEJIMIN E PRIVATIZIMIT TË TYRE**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ky ligj ka për qëllim transformimin e bankave tregtare shtetërore në shoqëri tregtare dhe lejimin e privatizimit të tyre.

Neni 2

Bankat tregtare shtetërore të transformohen në shoqëri tregtare. Bankat tregtare të transformuara në shoqëri tregtare do të funksionojnë në përputhje me dispozitat e ligjit nr.7560, datë 28.4.1992 “Për sistemin bankar” dhe të ligjit nr.7638, datë 19.11.1992 “Për shoqëritë tregtare”, për aq sa ky ligj nuk bie në kundërshtim me ligjin “Për sistemin bankar”.

Regjistrimi i bankave të transformuara në shoqëri tregtare të kryhet brenda datës 31 janar 1996.

Neni 3

1. Për të përgatitur bankat tregtare shtetërore për privatizim, ato duhet t’i nështrohen kontrollit të pavarur nga persona juridikë të specializuar.

2. Për bankat tregtare shtetërore, të bëhet sistemimi dhe pastrimi i bilanceve, rivlerësimi i aktiveve, portofoleve të huave dhe marrëdhënieve financiare midis tyre.

3. Në rastet kur del e nevojshme, të bëhet rikapitalizimi i bankave tregtare shtetërore.

Neni 4

Ministria e Financave dhe Banka e Shqipërisë të hartojnë sistemin e garantimit të depozitave.

Neni 5

Privatizimi i bankave tregtare shtetërore nuk duhet të prekë integritetin e sistemit të pagesave dhe llogarive, si dhe kryerjen me efektivitet të veprimeve për Buxhetin e Shtetit.

Neni 6

Ministria e Financave dhe Banka e Shqipërisë ngarkohen të hartojnë procedurat e privatizimit të këtyre bankave brenda datës 31 mars 1996.

Neni 7

Këshilli i Ministrave miraton procedurat e privatizimit të bankave tregtare shtetërore, ndërsa formula e privatizimit miratohet nga Kuvendi Popullor.

Neni 8

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.1297, datë 23.11.1995 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha